



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. <u>83</u>		
Datë/Datum. <u>07.05.2018</u>		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		

Datë: 04.05.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 68, të datës 19.04.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 54, paragrafi 54.1, paragrafi 54.2, nenin 55 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, nenin 29, paragrafi 29.3 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për emërimin e z. Qerim Gara në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 68, të datës 19.04.2018 për emërimin e z. Qerim Gara i lindur më datë 15.02.1953, me vendbanim në Fushë-Kosovë, me profesion murator, përfaqësues nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2017-2021.
2. I emëruari në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Udhëheqësit të Personelit, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 për pagesën e stafit politikë në komuna, të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. 84		
Data/Datum. 07.05.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.05.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 20, të datës 15.01.2018, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), nenin të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, nenin 11, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE NR. 63 TË DATËS 16.05.2013 DHE NDRYSHIMIT NR. 03 TË DATËS 10.01.2017

1. Me këtë ndryshim të 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale, Nr. 63', të datës 16.05.2013 dhe ndryshimit Nr. 03, të datës 10.01.2017 lidhur me nenin 8 të Rregullores bazë, të cekur më lart për lirim të subjekteve afariste nga taksa komunale për bizneset për vitin 2017, vazhdohet shfuqizimi i nenit 8 dhe pezullohet zbatimi i tij për vitin kalendarik 2018.
2. Qëllimi i ndryshimit të Rregullores dhe pezullimi i zbatimit të nenit 8 në vitin kalendarik 2018, është vazhdimi i lirimit të subjekteve afariste që zhvillojnë veprimtarinë e vet ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. 'Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale, Nr. 63', të datës 16.05.2013, Komuna e Fushë-Kosovës, në aspektin formal dhe përmbajtjesor, udhëzohet ta bëjë rishikimin e plotë të taksave/tarifave për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe profesionale për vitet e ardhshme, përmes hartimit të 'Rregullores për vendosjen e taksave/tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale', konform rekomandimit të Ministrisë së Financave, Nr. 217-1, të datës 16.02.2018 dhe harmonizimin e saj me dispozitat e legjislacionit në fuqi për fushat tjera që janë në kompetencat e pushtetit lokal.
4. Për zbatimin e këtij ndryshimi të 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale', për vitin kalendarik 2018, është kompetent Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

5. Ky ndryshim i 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr. 63', të datës 16.05.2013, hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës si dhe shfuqizon zbatimin e nenit 8 të Rregullores Nr. 63, të datës 16.05.2013 dhe ndryshimin e saj, Nr. 03, të datës 10.01.2017.

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës
Ndryshimi i Rregullores
Nr. 84 2018

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 85
Data/Datum 07.05.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 07.05.2018

Për: Qeverinë e Republikës së Kosovës - Zyrën e Kryeministrit, Kryeministrin e Kosovës z. Ramush Haradinaj.

Prej: Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Vjollca Konjusha

Lënda: Kërkesë për dhënien në shfrytëzim të pronës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për fillimin e bashkëpunimit të përbashkët për realizimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, si organ vendimmarrës për prona në territorin e Komunës, përmes kësaj shkrese zyrtare, kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kryeministri z. Ramush Haradinaj, dhënien në shfrytëzim të pronës së evidentuar në Ngastren Kadastrale Nr. P-72514003-00015-3 në Zonën Kadastrale Harilaç, në sipërfaqe prej $S = 85274m^2$, në vendin e quajtur 'Shume Shuma Pod Golesh', me synim bashkëpunimin e përbashkët për realizimin e investimeve të huaja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës tonë nga Kompania e jashtme 'Green-Tec Solutions' nga Polonia. Kompania në fjalë ka shprehur interesimin që të merret me: grumbullimin, ruajtjen, rikuperimin, prodhimin e lëndëve djegëse alternative, prodhimin e lëndëve djegëse të lëngëta, përmes një teknologjie që mundëson menaxhimin e shumicës së mbetjeve dhe mbeturinave të gjeneruara në territorin e Komunës tonë. Ju informojmë se përmes realizimit të këtij investimi të huaj dhe hapjen e kësaj Kompanie, pritet të punësohen rreth 150 punëtorë, planifikohet që realizimi i këtyre investimeve të bëhet brenda periudhës gjashtëvjeçare dhe kostoja e investimit vlerësohet të jetë rreth katër milionë euro. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës kërkon që kjo pronë të ndahet për investitorin - Kompaninë 'Green Tec Solutions', nga titullari i pronës Qeveria e Republikës së Kosovës, meqë, sipas vendimit Nr. 06/134, të datës 01.03.2017 dhe vendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Nr. 04/491/17, kjo pronë është pronë shtetërore, e azhurnuar në sistemin operativ të kadastrit më datë 21.03.2017. Ne mirëpresim qëndrimin zyrtar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Kryeministri z. Ramush Haradinaj, për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyeshme lidhur me këtë çështje në funksion të realizimit të investimeve të huaja dhe krijimit të vendeve të reja të punës, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe shpresojmë të marrim një përgjigje pozitive.

Kërkesës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës i bashkëngjitet dokumentacioni përcjellës!
Me respekt!